69-72	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
73,84-88	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
74-75	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
77,12	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
78-83	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

VENDIM
Nr.586, datë 2.6.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE
ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 3 qershor 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 25 (njëzet e pesë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë Thanë, në datën 5 qershor 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 18 (tetëmbëdhjetë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 3 qershor 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën që do të kalojë në datën 5 qershor 2009, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Autokolonat italiane gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.592, datë 25.5.2009

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË DISA MJEDISEVE AUTORITETIT TË KONTROLLIT
SHTETËROR TË EKSPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të disa mjediseve, konkretisht, katin e pestë teknik të ndërtesës, në adresën “Pallati nr.4, rruga “Skënderbej”, Tiranë, në administrim të Drejtorisë së Shërbimit Diplomatik, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


2. Për ndërhyrjet në konstruksion ose për përshtatjen e mjediseve, të dhëna në përdorim, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve duhet të marrë detyrimsht miratimin e administratorit të pasurisë.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Drejtoria e Shërbimit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANIMETRIA E KATIT TE IV DHE
Shkalla 1:125



SIP. NO. 525.7^a PER I EAT



OBJEKTI	GODINA NO. 525.7 ^a PER I EAT
TITULLI I PLETES	PLANIMETRIA E KATIT TE IV DHE V
PROJEKTUES	INZHINIERI EMBESHTIMIT DHE SHKENCES
GRUPET I PUNES	NO. 125

VENDIM
Nr.594, datë 28.5.2009


**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR
TË KONTABILITETIT**

Në mbështetje nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 20 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura organizative e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Organika e administratës së Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Numri i punonjësve të administratës së Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë, gjithsej, 6 veta.
 4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, miratuar për Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit.
 5. Vendimi nr.785, datë 22.11.2006 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të strukturës së nivelit të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, i ndryshuar, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



ORGANIKA E ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Pozicioni	Numri
Drejtor ekzekutiv	1
Inspektor (për standardet ndërkombëtare të kontabilitetit)	1
Inspektor (për standardet kombëtare të kontabilitetit)	2
Sekretar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit	1
Specialist (buxhet, financë, arkiv)	1
Punonjës gjithsej	6

VENDIM

Nr.595, datë 28.5.2009

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR
BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, TREGTAR DHE TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit, për bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, TREGTAR DHE TEKNIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Katarit, këtu e tutje të referuara si “Palët kontraktuese”,

me dëshirën për të zgjeruar dhe forcuar marrëdhëniet ndërmjet të dy vendeve në fushat e bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe teknik në interesin e tyre të përbashkët, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët kontraktuese bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre përkatëse mbi bazën e barazisë dhe interesit të përbashkët në fushat ekonomike, tregtare dhe teknike, si industria, energjia, bujqësia, komunikimet, transporti, ndërtimi, puna, turizmi dhe fusha të tjera.

Neni 2

Palët kontraktuese nxisin dhe lehtësojnë eksportin dhe importin e produkteve të tyre industriale dhe bujqësore, si dhe lëndëve të para, duke përjashtuar ato të ndaluara nga ligjet dhe rregulloret e importit dhe eksportit.

Neni 3

Palët kontraktuese nxisin dhe lehtësojnë transportin e mallrave reciprokisht ndërmjet tyre me anë të mjeteve të transportit që u takojnë atyre kurdoherë që të jetë e mundur.

Neni 4

Pagesat për transaksionet e përfunduara ndërmjet personave fizikë dhe juridikë brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje realizohen me anë të çdo valute të konvertueshme lirisht që bihet dakord ndërmjet të dy palëve të interesuara.

Neni 5

Secila palë kontraktuese:

1. Nxit dhe lehtëson pjesëmarrjen e tregtarëve, përfaqësueve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë dhe institucioneve të tjera në ekspozitat dhe panairët ndërkombëtare që realizohen në territorin e palës tjetër kontraktuese.

2. Lejon palën tjetër kontraktuese të organizojë panairë dhe ekspozita në çdo vend dhe i japin njëra-tjetrës të gjitha mjetet dhe asistencën e nevojshme për ta arritur këtë në kuadrin e ligjeve dhe rregulloreve të tyre përkatëse.

3. Në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi, përjashtojnë nga taksat doganore dhe tarifat e tjera fiskale artikujt e mëposhtëm me origjinë nga vendi i palës tjetër që nuk janë destinuar për shitje, kryesisht:

a) mallrat dhe materialet për panairë dhe ekspozitat e përkohshme që duhet të kthehen në vendin e origjinës;

b) modelet e mallrave, të përshtatshme për t’u përdorur si të tilla dhe me vlerë joekonomike.

Neni 6

Secila palë kontraktuese nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e vizitave ndërmjet përfaqësuesve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë dhe institucioneve të tjera të ngjashme, si dhe ndërmjet tregtarëve të të dy vendeve.

Neni 7

Secila palë kontraktuese:

1. Nxit bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të tyre qeveritare dhe institucioneve private dhe agjencive me interes publik të angazhuar në aktivitete teknike në ngritjen e projekteve të përbashkëta teknike dhe ekonomike, si dhe shkëmbimin e përfaqësuesve të angazhuar në disiplina të ndryshme teknike për të dhënë asistencën dhe mbështetjen e duhur.

2. Nxit dhe lehtëson pjesëmarrjen e qytetarëve në programet e trajnimit dhe orientimit në lidhje me fushën teknike dhe ekonomike dhe bashkërendon përpjeket në kërkimet dhe studimet përkatëse në këto fusha.

Neni 8

Për zbatimin e efektshëm të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe zgjidhjen e problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit, palët kontraktuese bien dakord të ngrenë një komision të përbashkët për bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe teknik për t'u takuar periodikisht në të dy vendet pas një kërke nga njëra palë kontraktuese për të:

1. propozuar procedurat për lehtësimin e ekzekutimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;
2. studiuar mjetet e nevojshme që kërkohen për të nxitur bashkëpunimin ekonomik, tregtar, kulturor, bujqësor dhe industrial mes dy vendeve;
3. zgjeruar dhe nxitur objektin e shkëmbimeve tregtare dhe eliminimin e pengesave;
4. rënë dakord për zgjidhjen dhe përmirësimin e problemeve që lindin nga interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje;

5. hartuar propozime në lidhje me ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje në ndjekje të zgjerimit të aspekteve të shkëmbimeve tregtare dhe zhvillimi e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet dy vendeve.

Neni 9

Palët kontraktuese marrin përsipër të zgjidhin mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje me anë të konsultimeve dhe bisedimeve miqësore.

Neni 10

Kjo Marrëveshje nuk ka ndikim mbi marrëveshjet e tjera që janë lidhur ose do të lidhen nga njëra palë me një shtet tjetër.

Neni 11

Çdo shtesë dhe amendim ndaj kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet me pëlqimin e palëve kontraktuese. Këto shtesa dhe amendime bëhen në formën e një instrumenti të veçantë, duke qenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje, dhe hyn në fuqi në pajtim me dispozitat e nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e shkëmbimit të notave diplomatike nëpërmjet të cilave palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre ligjore të brendshme që janë të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Ajo mbetet në fuqi për një periudhë fillestare prej pesë vjetësh dhe pas kësaj vazhdon të mbetet në fuqi për një afat të pacaktuar, përveç kur njëra palë njofton palën tjetër me shkrim në lidhje me qëllimin e saj për të pushuar fuqinë e saj, të paktën gjashtë muaj para datës së pushimit të fuqisë së përmendur.

Në rastin e pushimit të fuqisë, të gjitha detyrat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj apo nga marrëveshjet e arritura në pajtim me rregullat e saj, mbeten në fuqi detyruese.

Bërë në Doha, më 10 mars, 2009, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim teksti në gjuhën angleze ka përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë
Ministri i Financave

Për Qeverinë e Shtetit të Katarit

VENDIM
Nr.597, datë 28.5.2009

**PËR NDRYSHIMIN E EMRIT DHE PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË
STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE “UFO DENTAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5, 40, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërtimi dhe emri i shkollës së lartë universitare, private “UFO dental”, ndryshon në universiteti privat “Ufo University”.

2. Lejimin e universitetit privat “Ufo University”, Tiranë, për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në fushën “Psikologji klinike”.

3. Kohëzgjatja normale e programit të studimit të ciklit të dytë të jetë 2 vite akademike, me plotësimin, së paku, të 120 krediteve. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND) në psikologji klinike.

4. Lejimin e universitetit privat “Ufo University”, Tiranë, për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë” në fushat:

- a) Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci;
- b) Shkenca penale;
- c) E drejtë private;
- ç) Qeverisje dhe administrim publik.

5. Programet e studimit “Master i nivelit të parë” janë pjesë e studimeve të ciklit të dytë, me së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP) në:

- a) Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci;
- b) Shkenca penale;
- c) E drejtë private;

ç) Qeverisje dhe administrim publik.

6. Lejimin e universitetit, privat “Ufo University”, Tiranë, për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të dytë” në fushën: “Studime për sigurinë”.

7. Programi i studimit “Master i nivelit të dytë” të jetë program i studimit të ciklit të tretë, me, së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në mbarim të programit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND) në “Studime për sigurinë”.

8. Ngarkohet universiteti, privat “Ufo University”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

9. Universiteti privat “Ufo University” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 2, 4 e 6 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

10. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Universiteti privat “Ufo University” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit dhe këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.598, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1619, DATË 2.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE PËR EFEKT PAGE DHE CAKTIMIN E KUFLJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe të neneve 24, 32 e 54 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të bashkisë së Tiranës”, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, në njësitë bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave”, që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.3 “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të këshillit të qarkut”, që përmendet në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Në pikën 5, paga e grupit bëhet 12 000 lekë në muaj.

d) Lidhja nr.4 “Klasifikimi i vendeve të punës në shërbimin civil, për organet e qeverisjes vendore”, që përmendet në pikën 10, zëvendësohet me lidhjen nr.4 “Klasifikimi i vendeve të punës për nëpunësit civilë të bashkive e të qarqeve dhe për nëpunësit e komunave”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Lidhja nr.5 “Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë së bashkive e të komunave”, që përmendet në pikën 13, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

e) Në pikën 19, vlerat “...nga 17 000 lekë deri në 28 000 lekë në muaj.” bëhen “... nga 18 000 lekë deri në 30 000 lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga të ardhurat e vetë njësive të qeverisjes vendore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKINË E TIRANËS

PAGA MUJORE (LEKË)					
KLASA	KATEGORITË	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	12000	2%		Nga 67 000 deri 115 000
II	II-a	12000	2%		Nga 64 000 deri në 105 000
	II-b	12000	2%		Nga 56 000 deri në 88 000
III	III-a	12000	2%		Nga 30 000 deri në 69 000
	III-a/1	12000	2%		Nga 26 000 deri në 60 000
	III-b	12000	2%		Nga 24 000 deri në 52 000
IV	IV-a	12000	2%		Nga 22 000 deri në 41 000
	IV-b	12000	2%		Nga 20 000 deri në 31 000

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË E TJERA, NJËSITË BASHKIAKE TË TIRANËS DHE NËPUNËSIT E KOMUNAVE

PAGA MUJORE (LEKË)								
KLASA	KATEGORITË	PAGA INDIVIDUALE	SHITESA E POZICIONIT					
				Njësi të qeverisjes vendore mbi 100 000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 50001-100 000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 20001-50 000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 5001-20 000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me më pak se 5000 banorë
	1	2	3	4	5	6	7	8
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi në punë	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion
I	I-b	12000	2%	Nga 23 000 deri 63 400	Nga 20 200 deri 57 000	Nga 18 600 deri 46 000	Nga 17 600 deri 31 500	Nga 15 000 deri 26 000
II	II-a	12000	2%	Nga 22 000 deri 60 000	-	-	-	-
	II-b	12000	2%	Nga 18 600 deri 50 800	Nga 17 600 deri 46 000	Nga 15 000 deri 36 500	Nga 14 500 deri 31 000	Nga 14 000 deri 23 300
III	III-a/1	12000	2%	Nga 18 000 deri 45 000	Nga 16 600 deri 40 000	Nga 14 700 deri 34 500	Nga 13 500 deri 27 500	Nga 13 000 deri 22 500
	III-b	12000	2%	Nga 17 600 deri 40 800	Nga 15 000 deri 37 500	Nga 14 300 deri 32 500	Nga 13 000 deri 25 500	Nga 12 000 deri 22 000
IV	IV-a	12000	2%	Nga 11 000 deri 28 600	Nga 11 000 deri 26 500	Nga 10 000 deri 25 500	Nga 10 000 deri 24 000	Nga 10 000 deri 18 600
	IV-b	12000	2%	Nga 10 000 deri 26 000	Nga 9500 deri 23 000	Nga 9500 deri 19 000	-	-

Shënim: Këshilli i bashkisë dhe komunës në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicion, sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin e banorëve të Regjistrit të Gjendjes Civile, në filim të vitit kalendarik.

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË KËSHILLIN E QARKUT

PAGA MUJORE (LEKË)					
KLASA	KATEGORITË	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	12000	2%		Nga 36 000 deri në 69 000
II	II-a	-	-		-
	II-b	12000	2%		Nga 23 500 deri në 52 000
III	III-a/1	12000	2%		Nga 21 500 deri në 45 000
	III-b	12000	2%		Nga 18 000 deri në 41 000
IV	IV-a	12000	2%		Nga 11 500 deri në 31 000
	IV-b	12000	2%		Nga 10 500 deri në 23 000

KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS PËR NËPUNËSIT CIVILË TË BASHKIVE E QARQEVE DHE PËR NËPUNËSIT E KOMUNAVE

Vendet e punës për nëpunësit civilë të bashkive e qarqeve dhe për nëpunësit e komunave grupohen në 4 klasa si më poshtë:

Klasa I: Ka përgjegjësinë për menaxhimin e institucionit, përcaktimin e programeve të përgjithshme në fushat që mbulon institucioni, koordinimin e këtyre programeve të përgjithshme dhe përdorimin eficient të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj., për arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e këshillimit përfundimtar dhe të drejtpërdrejtë drejtuesit të institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

I-b Sekretar i Përgjithshëm (atje ku krijohet në bazë të strukturës)

Klasa II: Është niveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e programeve në fushën që mbulon dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

II-a Drejtor i drejtorisë së përgjithshme

II-b Drejtor drejtorie

Klasa III: Bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja programore për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e programeve në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu dhe zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

III-a Përgjegjës sektori
Kryeinspektor

III-a/1 Përgjegjës sektori në Bashkinë e Tiranës, në administratën e qarqeve, në njësitë e qeverisjes vendore me 50 001-100 000 banorë dhe në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 100 000 banorë

Kryeinspektor

III-b Përgjegjës sektori;
Specialist i nivelit të lartë;
Inspektor.

Klasa IV: Kjo klasë merret me zbatimin e programeve ekzistuese, koordinimin e aktivitetit të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

IV-a specialist i nivelit të mesëm;
IV-b specialist.

Lidhja nr.5

STRUKTURA DHE KUFIJTË E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BASHKIVË E TË KOMUNAVE

Emërtesa	Paga (lekë/muaj)	
	Nga	deri
Kryeinspektor i policisë bashkiake të Tiranës	70 000	80 000
Kryeinspektor i policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50 000 banorë	55 000	63 000
Kryeinspektor i policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë	42 000	47 000
Inspektor i policisë bashkiake të Tiranës	55 000	63 000
Inspektor i policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50 000 banorë	38 000	43 000
Inspektor i policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë	32 000	37 000
Punonjës i policisë bashkiake të Tiranës	42 000	47 000
Punonjës i policisë në njësitë e qeverisjes vendore, me mbi 50 000 banorë	32 000	37 000
Punonjës i policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë	30 000	35 000
Punonjës i policisë në njësitë e qeverisjes vendore, deri në 5001 banorë	27 000	30 000

VENDIM
Nr.599, datë 18.3.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT, PËR DHËNIEN ME QIRA, ME
ÇMIMIN SIMBOLIK 1 (NJË) EURO, TË SHOQËRISË “BERATEKS” SHA BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, të mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien me qira, me procedurë 1 (një) euro/kontrata, të shoqërisë “Berateks” sh.a., Berat, për zhvillimin e një veprimtarie ekonomike.
2. Kriteret për dhënien me qira të kësaj shoqërie të jenë:
 - a) Investimi 50 pikë;
 - b) Punësimi 30 pikë;
 - c) Koha e fillimit të punës 20 pikë.
3. Për dhënien me qira të zbatohen procedurat e përcaktuara në vendimin nr.1712, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË

Shtetësja Fatime Kalemaj lindur në Hambar Fier dhe banues në fshatin Horishovë Fier kërkon shpalljen të zhdukur të shtetësit Xhevdet Kolemaj.

KËRKUESJA
Fatime Kulemaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë

Hyri në shtyp më 8.7.2009
Doli nga shtypi më 8.7.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë